
HIGHLIGHTS FOR THE ROLE IN THE " THE LEGEND OF RUGOVA "

Melihate Zeqiri

University in Prishtina, Faculty of Philology, Kosovo

Abstract: The unfinished forms of the verb, for the construction, were originally classified into two groups: the first group includes the unused partitions and other forms that were built on its base: untouched form and antiquity (according to construction, in this the group includes also typewritten workers), while in the second group are included unmodified forms of wash and wash type (this group includes a wash), built on the basis of neutral neutral name (type, wash). To make the analysis of untranslated verb forms we have assigned a corpus from Rugova's collection, Zymer Ujkan Neziri, Rugova's legendary Epic. In this volume we have found and analyzed unsupported verb forms. Within this corpus emerge these unformed forms: partial (kie, vo: jt, za: n), obscene (p'a marr, without saying, without saying), transcript (tye ma: rr , tye ba :, tye e fa: l), the guy of the type with me: st, with kie, n, told me, (also comes in the form for me, for me: st, for me :). According to ethnologist Shaban Sinani, "Rugova's heroic epic, faithfully published by Zymer Neziri, as carried by living subjects: faithfully in lexicon, phraseology, phonetics and phonology, can serve the history of language, history and stratification (especially of Slavs and Orientalisms), the history of beliefs, the history of culture and civilization, and the history of gaining influences from other oral traditions.

Keywords: The verb, unformed, partial, passive, transcendent, obscene, epic, legendary, Rugova.

FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES NË „EPIKËN LEGJENDARE TË RUGOVËS”

Melihate Zeqiri

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Kosovo

Abstakt: Format e pashtjelluara të foljes, për nga ndërtimi, fillimisht janë klasifikuar në dy grupe: në grupin e parë janë përfshirë *pjesorja* dhe format e tjera të pashtjelluara që janë ndërtuar mbi bazën e saj: *forma e pashtjelluar mohore* dhe *përcjellorja* (sipas ndërtimit, në këtë grup përfshihet edhe paskajorja e tipit *me punue*), kurse në grupin e dytë janë përfshirë format e pashtjelluara të tipit *për të larë* e *me të larë* (në këtë grup futet edhe *një të larë*), që janë ndërtuar mbi bazën e emrit prejfoljor asnjans (të tipit, *të larë*).

Për të bërë analizën e formave të pashtjelluara të foljes ne kemi caktuar një korpus nga koleksioni i Rugovës, i Zymer Ujkan Nezirit, *Epika legjendare e Rugovës*, V. Në këtë vëllim kemi gjetur dhe kemi analizuar format e pashtjelluara të foljes. Në kuadër të këtij korpusi dalin këto forma të pashtjelluara: pjesore (*kie:n, vo:jt, za:n*), mohore (*p'a marr, pa za:n, pa tha:n*), përcjellore (*tye ma:rr, tye ba:, tye e fa:l*), paskajorja e tipit *me ma:rr, me kie:n, me i tha:n*, (del edhe në formën *për me za:n, për m'e ma:rr, për me pa:*). Sipas etnologut Shaban Sinani, “Epika heroike e Rugovës, e botuar besnikërisht nga Zymer Neziri, ashtu si bartet prej subjekteve të gjalla: besnikërisht në leksik, në frazeologji, në fonetikë e fonologji, mund t'i shërbejë historisë së gjuhës, historisë dhe shtresimeve të huajtjes së fjalëve të huaja (veçanërisht të sllavizmave dhe të orientalizmave), historisë së besimeve, historisë së kulturës e të qytetërimit dhe historisë së përfitimit të ndikimeve prej traditash të tjera gojore”.

Fjalë kyçe: Folja, forma e pashtjelluar, pjesore, paskajore, përcjellore, mohore, Epika, legjendare, Rugova.

HYRJE

Format gramatikore të foljes në gjuhën shqipe ndahen në dy grupe të mëdha: në *forma të shtjelluara* dhe në *forma të pashtjelluara*. Ndarja e tillë bëhet duke u bazuar në mundësinë apo pamundësinë e tyre për të ndryshuar, sipas vetës e numrit. Në grupin e *formave të shtjelluara* të foljes hyjnë format e ndryshme gramatikore të kohëve të mënyrave dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore, kurse në grupin e dytë, në atë të *formave të pashtjelluara* të foljes hyjnë format e ngurosurat të pjesores: *larë*, të përcjellores: *duke larë*, të formës së pashtjelluar mohore: *pa larë*, si dhe format e pashtjelluara të tipit *për të larë* e *më të larë* (ASHSH, 2002: 285). Ne kemi trajtuar format e pashtjelluara të foljes në të folmen Rugovës, krahu verilindor i gegërishtes. Në të folmen e Rugovës është regjistruar besnikërisht (këndimi dhe deshifrimi) edhe koleksioni me 15 vëllime *Epika legjendare e Rugovës* i Zymer Ujkan Nezirit. Për analizë kemi përzgjedhur vëllimin *Epika legjendare e Rugovës, V, këngë kreshnike e balad*, kënduar nga lahutari Haxhi Meta-Nilaj, këngë të hulumtuara, të incizuara, të transkriptuara dhe të përgatitura për shtyp nga Zymer Ujkan Neziri, më 1997.

1. E FOLMJA VERILINDORE E KRAHINËS SË RUGOVËS

“Të folurit e Rugovës mund të mirret si një idiom i nëndialektit të kosovarishtes me të cilën ban pjesë në kryedialektin e gegnishtes. Kjo e folme karakterizohet me një ngjyrë shqyptimi disi ma ashpër se shqyptimi i zakonshëm i shqipes dhe sidomos shqyptimi i zanoreve ma përhundët e me një theksim dhe tonalitet të fjalëve në mënyrë të posaçme”. (Begolli, 1958: 311) “E folmja, rugovishtja, është ruajtur, por ka pësuar edhe ndikime nga Peja dhe nga Rrafshi i Dukagjinit”. (Neziri, 1997:12). E folmja e Rugovës, bënë pjesë ndër ato të folme të gegërishtes që pjesoren e formon nga rrënja e foljes pa ndonjë mbaresë të caktuar (**la:**, **tha:**, **pshe:l**, **za:n** etj). (Hajdaraj, 1996: 144) Kjo e folme i njeh të gjitha trajtat e infinitivit gegë. (Gjinari, 1975: 157). Në radhë të parë përdorim të dendur në këtë të folme, ka tipi i paskajores geqe me pjesëzën **me**, e tipit: **me la:**, **me ble:dh**, **me za:n** etj.

Haset dendur edhe paskajorja e tipit **për me la:**, **për me ble:dh**, **për me vo:jt**, **për me za:n** etj. Abdullah Zymberi (Zymberi, 2016: 509), nga sistemi foljor në vëllimin *Epika legjendare e Rugovës, I, këngë kreshnike e balada*, veçon mënyrën paskajore, e cila del më shpesh me pjesëzën formante – *për me* -, si: Ani, Muja gati me shokë **për me shkua**. (f.158); Përcjellorja del me pjesëzën formante –*tye*- , si: Gjith’ **tye** ke:sh e po gajret **tye** ba:

Sipas Ina Arapit (Arapit 2016: 569), në vëllimin *Epika legjendare e Rugovës, I, këngë kreshnike e balada*, paskajorja e foljes *jam* del në trajtën *me kjenë*. Trajta mohore e paskajores formohet me pjesëzën mos: *mos me folë* (17,4). Folja *me pa* shoqërohet shpesh prej kundrinës së zhdrejtë me sy dhe merr kështu trajtën e shprehjes foljore me e pa me sy. P. sh.: Ani, *me ma pru e me sy e me e pa* (74, 51).

2. EPIKALEGJENDARE E RUGOVËS

Sipas etnologut Shaban Sinani, Zymer Neziri e ka nisur këtë veprimtari shumë herët. Veç pasionit të studiuës të epikës legjendare në përgjithësi, në këtë punë e ka nxitur edhe thirrja e të parëve, zëri i vendlindjes, tradita që ai ka mbrenda vetes: njeri i letrave po aq sa edhe i rregullit të rreptë të të parëve. Mund të thuhet se Zymer Neziri, si në rrallë raste, nuk është ende i çmagjepsur prej kësaj tradite dhe prej këtij rregulli të kryehershëm, prej “mallkimit të ëmbël të së shkuarës”, që e patën konstatuar së pari koleksionistët amerikanë M. Parry dhe A. Lord. (Neziri, 2009: IX). Sipas prof. Abdullah Zymberit, “Zymer Ujkan Neziri është njëri ndër mbledhësit më të përpiktë të epikës sonë dhe ndër studiuës të më të thellë të kësaj fushe jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

Ky zelltar i epikës së Rugovës, i epikës sonë, ka arritur me punën e tij të palodhshme të mbledhë dhe të sigurojë material të mjaftueshme për përgatitjen e pesëmbëdhjetë blejve të kësaj fushe. Kështu bëjnë vetëm studiuës të mëdhenj, të cilët e flijojnë dhe e harrojnë vetveten për të mirën e popullit. Dijetari ynë Neziri e shkriu një jetë të tërë për të ruajtur një pjesë të krijimtarisë popullore pikërisht epikën legjendare të Rugovës, e cila është në të zhdukur, prandaj, pa e tepruar, mund të shtojmë se këtij dijetari të zellshëm s’mund t’i gjendet shoqi gjallë në këtë fushë kërkimesh”. (Zymberi, 2016: 505)

2.1. Epika Legjendare e Rugovës, V, këngë kreshnike dhe balada, lahutari Haxhi Meta-Nilaj

“Haxhi Meta-Nilaj, i lindur në pranverë të vitit 1912 në lagjen Bollopaçë të katundit Shtupeqi i Vogël, është ndër lahutarët më të mire që i ka pasur Rugova deri më sot. Rugova, të cilës i takon edhe Shtupeqi i Vogël, është krahinë e vogël etnografike dhe gjeografike në Alpet Shqiptare”. (Neziri, 1997:9) “Haxhi Meta ishte njeri gojëmbeldhe shumë i afërt me njerëz. Çmohej ndër burrat e nderuar të Nilajve”. (Po aty, 14).

2.2. Format e pashtjelluara të foljes në “Epiken legjendare të Rugovës, V”

Për të bërë analizën e formave të pashtjelluara të foljes, ne kemi caktuar një korpus nga koleksioni i Rugovës, që është: *Epika legjendare e Rugovës, V*, i cili përmban tridhjetë këngë kreshnike dhe balada. Në këtë vëllim ne kemi gjetur dhe analizuar format e pashtjelluara të foljes.

2.2.1. Përdorimet e pjesores te “Epika legjendare e Rugovës, V”

Disa forma të pjesores dalin pa asnjë prapashtesë, si p. sh.

- a. Forma të tipit si: punue, fitue, ngarkue, nënçmue, jetue, zhvillue, shkue, kërcye, lye etj., të cilat në të tashmen e dëftores dalin me temë në zanore, në -o- ose -e- (puno-j, ngarko-j, shko-j, kërcë-j etj), dhe në të kryerën e thjeshtë, në dy vetat e para të njëjësit dalin me mbaresat -va, -ve: puno-va, puno-ve; ngarko-va, ngarko-ve; kërcë-va, kërcë-ve etj. Ky tip i foljeve që klasifikohen në nënklasën I të klasës I të zgjedhimit I, në shumësin e së kryerës së thjeshtë dhe në pjesore, e zbërthejnë zanoren fundore të temës në një tog zanoresh (në shqipen standarde): -ua-, -ye- dhe marrin prapashtesën -r si: punua-r, zhvillua-r, lye-r. Kurse për dallim nga shqipja standarde, në Epiken legjendare të Rugovës, foljet që dalin me temë në -o-, nuk e zbërthejnë zanoren fundore në togun -ue-, mirëpo, në togun -ua- dhe nuk marrin prapashtesë fare si, p.sh.: kallxua, shkua, fillua, rrethua etj. Ndërsa ato folje që dalin me temë në -e-, njëjtë sikur në shqipen standarde, kjo -e- zbërthehet në -y-, mirëpo, për dallim nga shqipja standarde, në të folmën e Rugovës, edhe këto forma dalin pa prapashtesë.

- b. Pa prapashtesë, të Epika legjendare e Rugovës, V dalin edhe foljet e tipit si: ba, pre, vra etj., e para prej të cilave del me një a hundore, e cila zëvendëson ë-në e theksuar (ba – bë -rë), dhe si e tillë del pa prapashtesë, dhe foljet e zgjedhimit të dytë si: pre-s e vra-s, të cilat në shqipen standarde formën e pjesores e formojnë me prapashtesën –rë: pre-rë, vra-rë, la-rë, ndërsa te Epika legjendare e Rugovës, V dalin pa prapashtesë.
- c. Pa prapashtesë dalin edhe format e foljeve të parregullta supletive, si: bie e shoh dhe foljet e zgjedhimit të tretë si: pi e vë, të cilat në formën e pjesores të Epika legjendare e Rugovës, V dalin si ra e pa përkatësisht pi e vu, ndërsa në shqipen standarde dalin me prapashtesat -rë/ -në: rë-në, pa-rë, pi-rë, vë-në.

Pjesorja e shqipes si gjymtyrë më vete ka një përdorim të kufizuar. Ajo shërben më fort si pjesë përbërëse formash analitike dhe sintetike. Në sistemin foljor ajo përdoret pas foljeve ndihmëse kam dhe jam për të ndërtuar kohët e përbëra të së shkuarës, të tashmen dhe të pakryerën e habitores dhe kohën e tashme të dëftores së disa foljeve. Pjesorja përdoret edhe pas foljeve gjysmëndihmëse modale *do* dhe *duhet* dhe gjithashtu shërben si pjesë përbërëse e formave të pashtjelluara të tipit *pa punuar*, *duke punuar* dhe *me punue*. Kështu, në vëllimin *Epika legjendare e Rugovës, V*, pjesorja del: *Ou, po kur ish kie:n, he, Sejan-e Ivani / E, po ku ish kie:n-e kralica e ba:rdh, / E, sa Halilin, he, rop-e e ke za:n, / E, n'xhy:s t'malit çat-he:r kur ja:n vo:jt, / E, ka ba: be:, po, syret-e t'ki:shs, / Eje, Nika n'bie:sh-e, çe besa, ish kie:n vo:jt, / E, tridhe:t shkie rop-e i ki za:n, / E, o, une izen çetash po ta ap, he! / E, po, a:gt e tu:, more ti na i ke pru:!? / Eje, o, çe i motmot, eh, n'burk t'kam shti:...*

3.MOHORJA NË VËLLIMIN “EPIKA LEGJENDARE E RUGOVËS, V”

Në vëllimin *Epika legjendare të Rugovës, V*, ashtu si edhe në mbarë shqipen, mohorja ndërtohet nga pjesëza parafjalore pa+pjesore e foljeve gjegjëse. Edhe brenda formës së privativit, pjesorja del me të njëjtën strukturë si kur përdoret më vete. Kështu që edhe brenda kësaj forme të pashtjelluar, pjesorja del e shkurtër apo e reduktuar për nga forma, në krahasim me pjesoren si trajtë normative në shqipen standarde. P.sh.: *pa gjetë* dhe *jo pa gjetur*, *pa punue* dhe *jo pa punuar*, *pa la* dhe *jo pa larë*. Bokshi thekson se pjesorja e shkurtër ka qenë e njëjtë për tërë shqipen (2011: 159) dhe se vetëm më pas me krijimin e mbiemrave prej pjesorë, përveç nyjës iu shtua edhe prapashtesa pjesores. Pastaj, këtë formë të mbiemrit, me prapashtesën që ishte tipike për ndërtimin mbiemëror, toskërishtja e bëri përfaqësuese edhe të pjesores, p.sh.: nga *la* (kam *la*) – mb. *i la-rë* e më pas edhe pjesorja *larë* (kam *larë*).

Privativi, bazuar në korpusin tonë, del mjaft rrallë krahasuar me përcjelloren apo paskajoren analitike; *E, ja pa gra:n-e, u ja pa pi: / Ani, e rop t'xha:ll, he, e ka pa za:n. / Ani, ish pa gra:n, he, nieri ish pa pi: / Ani, po a u ka la:n-e pa gra:n e pa pi: / Ani, cilli-o, kral, he, rop-e t'ka pa za:n / Ani, tridhe:t çika e mi:r-e u ki pa tha:n. / Eu, p'a merr vesh-e Deli Rizvan Aga! / Ani, me m'pa za:n, Deli, e si t'ka za:n. / Eje, se s'e la:m-e, hej, nuse pa: za:n! / E, nuk e le, he, dar shpa:t-e pa t'shti: / E, o, s'ka:n çare be?s-e përpa t'za:n! / Ani, o, nuk t'lsho:jn-e, tybe, për pa t'pre:....*

4.PËRCJELLORJA NË VËLLIMIN “EPIKA LEGJENDARE E RUGOVËS, V”

Përcjellorja është ajo formë e pashtjelluar e foljes e cila shpreh një veprim, i cili e shoqëron veprimin e foljes drejtuese, me të cilën kryhet zakonisht në të njëjtën kohë. Përcjellorja ka një kuptim kohor të kushtëzuar nga kuptimi kohor i foljes drejtuese. Duke qenë se veprimi i shprehur prej saj vërtetohet zakonisht në të njëjtën kohë me atë të foljes drejtuese, përcjellorja, sipas kontekstit mund të ketë kuptimin e së tashmes, të së shkuarës ose të së ardhmes. Përcjellorja ndërtohet nga pjesëza *tye* dhe pjesorja e foljes: *tye la: Eje, po si n'kjo:sh n'mehane tye pi: / Heje, po ti-o n'kjo:sh-e sabahin-o tye fa:l, / E, tye ba: lu:ft-e n'Kotorr-e tek ja:n, / Eje, o, tye i thye duert-e, te Muji-e a shkua: / E, tye ke:sh, po, tu sho:kt-e a vo:jt, / E, e n'ledi:n, he, Muji-e tye te:j, / E, po si n'kjo:sh sabahin tye e fa:l, / E, tye rrah shpla:k-e shkallave a hi:p, / Heje, t'dyja djepet, besa, tye i përku:d, / Heje, kapak dri:th-e, u, tye ly:p, / E, a tye py:t-e lloçi me zheva:r? / O, tye gra:n, çe besa, tye pi: / Eje, për Halilin, Mu:j-e, tye pri:t....*

5.PASKAJORJA E TIPIT ME LA NË VËLLIMIN “EPIKA LEGJENDARE E RUGOVËS, V”

Paskajorja analitike e tipit *me la*, siç dihet, nuk është përfshirë në shqipen standarde. Si zëvendësim i saj del paskajorja e tipit *për të larë*. Në sferën dialektore paskajorja e tipit *me la* ka një përdorim shumë të dendur. Për nga ndërtimi, sinkronikisht, paskajorja e këtij tipi paraqitet e formuar nga pjesëza parafjalore *me + pjesore e shkurtër*. Te “Epika legjendare e Rugovës, V”, përdoren të dy tipat e paskajores, por paskajorja e tipit *me la* ka përdorim më të dendur. Ajo përdoret:

- **Pas foljeve modale:** Në ndërtimet folje modale + paskajore, folja modele bart kuptimet kryesore gramatikore duke treguar mënyrën, kohën, vetën dhe i jep gjithë ndërtimit kuptim modal, ndërsa paskajorja bart kuptimin

themelor leksikor dhe tregon kategorinë gramatikore të diatezës. Kështu, në korpusin tonë, paskajorja pas foljeve modale del në këto raste:

Mund + paskajore: *E, a kishe muejt, ehe, ti-e m'e njo:ft?/ Ani, n'mujsha shkiau-e, Halil-e, m'e za:n./ Ani, nuk ka muejt-e, u me t'njo:ft!/ He, po n'mujsh prapa, po, mua, me m'ra,/ E, as nuk mundet shejin-e m'e thye./ E, as nuk mundet, po, brenda po me hi: ...*

Duhet + paskajore: *E, o, për dere-e do-em'e da:l/Eje, o, dua dar shpa:t, kopilin-e m'e shti://Ani, do për ymër n'ku:ll s'ka me vo:jt!/Eje, o, po dua n'shpi:d, ehe, na:n, e me i ra: Ani, duem me da:l halilin-e m'e ly:p./E xhithsa t'duesh-e dukat ka me t'dha:n./Ani, duen me u pre: he, duen-e me u coptua.*

- **Paskajorja me folje aspektore:** Foljet aspektore kur përdoren bashkë me paskajoren tregojnë fillimin, vazhdimin dhe mbarimin e veprimit të shprehur nga folja në paskajore. Sipas A. Dhrimos (M. Priku, 2012:38), foljet si *marr*, *vë* të ndjekura nga një lidhore, krahas mënyrës së fillimit të veprimit, përmbajnë edhe idenë e intensitetit të veprimit, pra shprehin një fillim intensiv të tij. Në vëllimin e pestë, foljet e tilla ndiqen nga paskajorja *me nis*, dhe shprehin fillimin e veprimit, ngërthyer me vlera intensive, pra shprehin një fillim intensiv të një veprimi; *Ani-e, eu, me shpata-e me u pre:./ Ani, e ka:n ni:s me u dre:dh e me u përdre:dh./ E, o, ku m'e ma:rr, Halili e ka zapua...*

6.PASKAJORJA E TIPIT PËR ME LARË TE “EPIKA LEGJENDARE E RUGOVËS, V”

Krahas paskajores së tipit *me larë*, del edhe paskajorja e tipit *për me larë*. Ky tip paskajoreje historikisht sqarohet si i ndërtuar nga pjesëza parafjalore *për + një emër prejfoljor asnjanes*. Duke qenë se emrat prejfoljorë asnjanes në gjuhën shqipe po vijnë duke u pakësuar gjithnjë e më shumë, kurse format e pashtjelluara të tipit *për të larë* e *me të larë* (sidomose para) mund të formohen për çdo folje, në gjuhën e sotme shqipe, këto forma interpretohen si forma të pashtjelluara që ndërtohen mbi bazën e pjesores (Gramatika, I, 2002: 299). Edhe në këtë ndërtim, trajta e pjesores nuk del e plotë, por e shkurtës: *për me la*, *për me dal*, *për me ardh* etj. Në korpusin tonë, paskajorja e këtij tipi del: *Eje, paj diku, he, nuse, o, për me za:n./ Ani, për m'e ma:rr, eu, Llatinkën e Ba:rdh./ E, po, ka çef, he, u për me pa:!/ E, paj, çet pu:shk-e a do për m'e ma:rr-e/ E, për konopve, turko, për me dri:p./ Ani, se nuk muj, he, bu:kn-e për m'e gra:n./ Hajt n'ku:ll-e, motër, për me hi:./ Ani, nuk po mundet shkiau-e për me luejt./ Ehe, paj, n'to:k-e, ti-e, për me ra:./ E, o, s'ka:n çare be:s-e për pa t'za:n!./ Ani-e, po ka ni:s-e raki:-o për me pi:./ He, çou n'mejdan, he, dushman për me dal/....*

PËFUNDIM

Pas studimit të bërë për format e pashtjelluara të foljes, te *Epika legjendare e Rugovës, V*, të Zymer Ujkan Nezirit, dalin këto forma të pashtjelluara:

- pjesorja (*ma:rr, kie:n, za:n, vo:jt, ba:, ra:, a:rdh, dha:n, la:n, pi:, ep, pru:, tha:n*)etj;
- përcjellorja (*tye ma:rr, tye pri:t, tye i çua, tye da:l, tye ba:, tye pi:*)etj;
- mohorja (*p'a me:rr, pa za:n, pa kie:n, pa pi:, pa gra:n, pa tha:n, pa t'shti:, pa dre:dh-e*)etj;
- paskajorja e tipit *m'e ma:rr, me shkua, me t'kallxua, me u afrua, me kie:n, me pa:, m'e za:n, me ra, me ba:, me vo:jt-e, me pri:t, me la:n*, (e cila del në disa raste e paraprirë nga parafjala *për: për m'e ma:rr, për me pi:, për me za:n, për m'e ba:, për me i ra:, për me a:rdh, për me dal*) etj.
- Format e pashtjelluara të foljes në vëllimin, *Epika Legjendare e Rugovës, V*, dalin të ndryshme për nga forma, krahasuar me format e pashtjelluara të foljes në shqipen normative. Kështu ato dalin në këtë formë: *ma:rr – marrë/ da:l – dalë, tye da:l – duke dalë, pa da:l – pa dalë, me da:l* (pa ndonjë zëvendësim të plotë në shqipen standarde) dhe *për me dal – për me dalur*.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Altimari, Françesko (2010). "Gjurmë të paskajoreve të shqipes në arbërishten e Italisë," në: *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- [2] Arapi, Ina (2010). "Variantet fonetike dhe funksionet sintaksore të paskajores gege te *Epika legjendare e Rugovës, I*, nga Zymer Neziri", në: *Eposi i Kreshnikëve: monument i trashëgimisë kulturore shqiptare*, vëllimi II, konferencë shkencore ndërkombëtare, Prishtinë, 28-30 gusht 2010, kryeredaktorë prof. dr. Zymer Ujkan Neziri dhe prof. dr. Shaban Sinani, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës, Prishtinë, f. 567-594.
- [3] Bokshi, Besim (1998). *Paskajorja e shqipes (vështrim diakronik)*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- [4] Bokshi, Besim (2011). *Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe*, Botimet Albanologjike, Tiranë.
- [5] Begolli, Menduh (1958). "Të folunit e Rugovës me disaveçori të veta", në: "Përparimi", revistë kulturore, numri 5, maj 1958, drejtor përgjegjës Elhami Nimani, Prishtinë, f. 310-318

-
- [6] Çabej, Eqrem (1986). *Studime gjuhësore*, VII, "Rilindja", Prishtinë.
- [7] Demiraj, Shaban (1974). *Gramatika e gjuhës shqipe (Fonetika-Morfologjia)*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë.
- [8] *Gramatika e gjuhës shqipe I (2002)*, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
- [9] Hajdaraj, Adem (1996). *E folmja e Rugovës*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- [10] Munishi, Shkumbin (2011). *Mbi mundësinë e integritit të paskajores në gjuhën standard shqipe*, Botimet Albanologjike, Tiranë.
- [11] Neziri, Zymer Ujkan (2009). *Epika legjendare e Rugovës, bleu I, këngë kreshnike dhe balada*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- [12] Neziri, Zymer Ujkan (2011). *Epika legjendare e Rugovës, bleu II, këngë të kreshnikëve dhe balada*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- [13] Neziri, Zymer Ujkan (1997). *Epika legjendare e Rugovës V, këngë kreshnike dhe balada*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- [14] Palmer, Frank (2003). *Modality in english: Theoretical, descriptive and typological issues*, Modality in contemporary English, Berlin.
- [15] Riza, Selman (1997). *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Vepra 2, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- [16] Sinani, Shaban (2009). "Zymer Neziri, *Epika legjendare e Rugovës*", I, Instituti Albanologjik I Prishtinës," në: Zymer Ujkan Neziri, *Epika legjendare e Rugovës, I, bleu I, këngë kreshnike dhe balada*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, f. IX-XIV.
- [17] Sinani, Shaban (2011). "Epika heroike si etnotekst", në: Zymer Ujkan Neziri, *Epika legjendare e Rugovës, bleu II, këngë të kreshnikëve dhe balada*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, f. 7-17.
- [18] Xhuvani, Aleksandër (1956). *Studime gjuhësore*, Instituti i historisë e i Gjuhësisë, Tiranë.
- [19] Zymberi, Abdullah (2016). "Disa vlerime morfologjike, sintaksore dhe leksikore të *Epika legjendare e Rugovës*, I, nga Zymer Neziri", në: *Eposi i Kreshnikëve: monument i trashëgimisë kulturore shqiptare*, vëllimi II, konferencë shkencore ndërkombëtare, Prishtinë, 28-30 gusht 2010, kryeredaktorë prof. dr. Zymer Ujkan Neziri dhe prof. dr. Shaban Sinani, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës, Prishtinë, f. 505-512.